



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 08.11.2022

NJOFTIM

ULET VIJA E FINANCIMIT PËR MASAT MBËSHTETËSE DIREKTE TË VITIT 2022

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “Listat e Aplikimeve të Kualifikuara”, të cilat gjenden në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al, për masa mbështetëse direkte, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2022.

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për aplikimet sipas masave mbështetëse të fermerëve dhe sipas listave të shpallura, në përputhje me procedurat e përcaktuara në Udhëzimin Nr. 1, datë 11.02.2022 i ndryshuar, “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural” i MBZHR dhe MFE.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve si dhe numrin e kodit të aplikimit që përfshihet mbi vijën e financimit.

- **Masa 1:** Mbështetje për fara/fidanë dhe impute të tjera – Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 813, për kodin e aplikimit me numër 13485.
- **Masa 3:** Mbështetje për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike – Vija e financimit ishte në numrin rendor 186 për kodin e aplikimit me numër 3250 – Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 187, për kodin e aplikimit me numër 3263.
- **Masa 4:** Fermat organike të çertifikuara – Vija e financimit ishte në numrin rendor 97 për kodin e aplikimit me numër 10638 – Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 98, për kodin e aplikimit me numër 10658.
- **Masa 5:** Implementimi dhe certifikimi Global GAP – Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 56, për kodin e aplikimit me numër 13454.
- **Masa 6:** Për tufën bazë të matrikulluar – Vija e financimit ishte në numrin rendor 4951 për kodin e aplikimit me numër 8104 – Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 5120, për kodin e aplikimit me numër 8427.
- **Masa 7:** Mbarëshitim i bletarisë – Vija e financimit ishte në numrin rendor 1368 për kodin e aplikimit me numër 6659 – Janë përfshirë në fond aplikimet deri në numrin rendor 1371, për kodin e aplikimit me numër 6683.

Agropikat janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Fermerët të cilët iu përshihet aplikimi me fond të buxhetit të shtetit në datë **08.11.2022**, kanë afatin e dorëzimit të dokumenteve shtesë deri në datë **23.11.2022**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.